



DREJTORIA PËR MBROJTJE, SHPËTIM DHE
SHËRBIME PUBLIKE

09 Nr.
Dt. 24. 02. 2020

NJOFTIM

Qytetar të nderuar, meqenëse tani ndodhemi në sezonin e zjarreve, ku mbretërojnë temperatura të larta, mundësia e ndodhjes së zjarreve në pyje dhe parqe nacionale është shumë e mundshme. Me qëllim të shtimit të masave preventive nga aspekti i mbrojtjes ndaj zjarrit si dhe evitim- pengimin e rreziqeve potenciale nga zjarri në zonat fushore dhe malore duhet ti kushtojmë kujdes të veçantë kësaj dukurie e cila do të kishte për pasojë rrezikimin e jetës së njerëzve, kafshëve dhe dëmtimit të sipërfaqeve pyjore.

Komuna jonë posedon një sipërfaqe të madhe të kullosave dhe pyjeve po ashtu edhe objekteve të përkohshme të banimit të cilat janë të ndërtuara nga materiali i drurit i cili ndezet lehtë.

Duke u bazuar në këtë luteni që të keni kujdes të veçantë që gjatë qëndrimit në këto zona malore-fushore të ndërmerren këto masa parandaluese:

- Hedhja e cigareve të ndezura në pyje dhe në tokat pyjore me vegjetacion njëvjeçar moçalorë të thatë, gjethe e të tjera ;
- Tymosja e bletëve në pyll ;
- Ndezja e zjarreve hapura në afërsi dhe brendësi të sipërfaqeve pyjore ;
- Lokalizimi dhe shuarja e zjarrit në vende ku zjarri është ndezur për nevoja pikniku ;
- Përdorimi i tapave të fishekëve të gjahut prej materialit që merr zjarr lehtë ;
- Qitja me predha që shkaktojnë zjarr në zona pyjore me mbeturina drusore si : gjethe, shkarpa, kalbësira etj ;
- Ndalohet kategorikisht ndezja e zjarreve në kullota deri në 500 m në afërsi të pyllit ;
- Ndalohet djegia e mbeturinave të masës drusore në pyje.

Këto masa parandaluese janë të obliguar ti ndërmarrin të gjithë qytetarët sepse obligojnë dispozitat e Ligjit për mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera Nr.04/L-027 si dhe Ligji për Mbrojtje nga Zjarri Nr.04/L-012.

Për mos respektimin e këtyre masave parandaluese ndaj zjarrit do të ndërmerren masa ndëshkuese nga organet kompetente.

Dëmtimi i pyllit nga zjarri me dashje apo nga pakujdesia, dënohet në bazë të dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Stampa e Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike të Komunës së Deçanit. Përfshihet numri i dokumentit 5567, data 24-02-20 dhe shënimi 03.

DREJTORI I
Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe
Shërbime Publike
Izet Zenuni